

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i krerëve të UÇK-së, avokati i Thaçit
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/avokati-i-thacit-ngre-alarmin-per-verdiktin-e-speciales-e-li-dhi-pavaresine-e-kosoves-me-krime-lufte
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA

KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 08:30:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 08:25:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5323603e1572d493efd81369a1d11504ea9c14e7f8900c44f3bf568f04a27e7d
TEKSTI	b58a4859b3207362deca8dfdd5c6ea41c972badc3a93daa5d73b63a76ccf2e21
PAMJA	b7cd3d794d0868f1e9569abb09504594cebe091458ae2a86e2201b711095f701

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6f271f2b7ad95a7fe87dcf167cf8516dae33557256a7b31c76d01a7047e47263
E MËPARSHMJA	e2ad74e9fddfdbcfbe9cb600e21db301667f429986c8a60a5e6af5317f705e84
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6f271f2b7ad95a7fe87dcf167cf8516dae33557256a7b31c76d01a7047e47263>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Rama nis vizitën në SHBA me një takim me komunitetin shqiptar në Michigan: Ftoj çdo bashkëkombas të na bashkohet!



Kosova & Rajoni

Dënimi i krerëve të UÇK-së, avokati i Thaçit 'zbërthen' pasojat e verdiktit: Specialja po njollos luftën e UÇK-së, e lidhi pavarësinë e Kosovës me krimet e luftës

Sipas tij, edhe pse Gjykata nuk kishte kompetencë të vendoste mbi pavarësinë e Kosovës, në arsyetimin e aktgjykimit ka bërë një hap më tej, duke lidhur qëllimin për pavarësi me krimet e luftës.

■ Kërkesat për mbylljen e Speciales, Prokuroria e Hagës: Mandati mbaron kur të mbyllën hetimet



Luka Misić



Redaksia

19 Shtator, 10:16 | Përditësimi: 19 Shtator, 11:13

Share Tweet



Avokati i Hashim Thaçit, [Luka Misić](#), thotë se problemi më i madh i aktgjykimit të Gjykatës Speciale nuk janë vitet e dënimit, por një përfundim që, sipas tij, prek vetë luftën çlirimtare të UÇK-së. Sipas avokatit, në arsyetimin e vendimit gjykata ka shkruar se [pavarësia e Kosovës](#) u arrit, në një masë të konsiderueshme, përmes mjeteve kriminale.

Paralajmërimi i Misić erdhi pasi Marko Prelec, ish-bashkëpunëtor i Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë dhe ekspert i International Crisis Group, komentoi debatet e krijuara pas aktgjykimit. Prelec argumentoi se është e gabuar të thuhet se Gjykata Speciale ka vënë në bankën e të akuzuarve vetë të drejtën e Kosovës për pavarësi.



"E drejta e Kosovës për pavarësi, ashtu si e drejta e Kroacisë, nuk është dhe nuk mund të jetë në bankën e të akuzuarve. Të sillesh sikur është, vetëm na bën të dukemi keq", tha ai.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Preç Zogaj: Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

Sipas Prelecit, Gjykata nuk kishte juridiksion të gjykonte ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të thuhet se vendimi e shpall të paligjshme atë.

Por Luka Misić thotë se pikërisht këtu nis problemi. Sipas tij, edhe pse Gjykata nuk kishte kompetencë të vendoste mbi pavarësinë e Kosovës, në arsyetimin e aktgjykimit ka bërë një hap më



tej, duke lidhur qëllimin për pavarësi me krimet e luftës.



"Trupi Gjykses ka vendosur se një pjesë e qëllimit kriminal të anëtarëve të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale dhe 'të tjerëve në udhëheqjen e UÇK-së' ishte arritja e pavarësisë së Kosovës përmes krimeve të luftës. Madje as Prokuroria nuk kishte shkuar deri në këtë pikë. Marko Prelec ka pjesërisht të drejtë kur thotë se gjykata nuk e shpalli të paligjshme të drejtën e Kosovës për pavarësi, sepse nuk kishte juridiksion për ta bërë këtë, por ajo konstatoi se jetet e përdorura për ta arritur pavarësinë e Kosovës ishin, në një masë të konsiderueshme, kriminale", shprehet Misiç.

Për Misiçin, mënyra si është shkruar aktgjykimi prek mënyrën se si interpretohet lufta e UÇK-së dhe rruga që çoi në pavarësinë e Kosovës, ndaj kjo pritet të jetë një nga argumentet kryesore që mbrojtja do të ngrejë në Apel.

Sipas procedurës së Dhomave të Specializuara, palët kanë 30 ditë nga marrja e aktgjykimit të plotë me shkrim për të paraqitur njoftimin zyrtar të apelit dhe për të përcaktuar pikat që kundërshtojnë.

Pas këtij hapi, pala që apelon ka edhe 60 ditë për të dorëzuar argumentet e plota juridike. Më pas, pala tjetër ka 30 ditë për t'u përgjigjur, ndërsa apeliuesi edhe 15 ditë për kundërpërgjigje. Në fund të kësaj procedure, Paneli i Apelit mund ta lërë në fuqi aktgjykimin, ta ndryshojë ose ta rrëzojë atë.

Ndërkohë, ndërsa ekipet ligjore përgatiten për fazën e Apelit, reagimet në mbështetje të katër ish-krerëve të UÇK-së vijojnë edhe jashtë Kosovës. Platforma "Liria ka Emër" ka paralajmëruar për sot tubime në Zvicër, Gjermani dhe Kanada, ndërsa një tjetër është njoftuar për nesër në Austri, në mbështetje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

U.D/SLE/Shqiptarja.com

TAG: [Luka Misiç](#) [Gjyqi ndaj UCK ne Hage](#) [pavaresia e kosoves](#) [kosove](#) [hashim thaci](#) [uck](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



4.0 / 5 (4 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpaloset flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-krerët e UÇK (VIDEO)

20 Shtator, 21:28



Dënimi me 81 vite burg i 4 ish-krerëve të UÇK, shqiptarët protestë edhe në Vjenë të Austrisë: O Hashim, ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke! (VIDEO)

20 Shtator, 16:25



Njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

20 Shtator, 15:11



Verdikt i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interperlancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?

20 Shtator, 13:40



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Morinë 34-vjeçari nga Kosova (EMRI)

20 Shtator, 11:31



A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë

20 Shtator, 08:54



5 ditë pas vendimit të Hagës, Prishtina sërish në shesh: Na ka bashkuar UÇK-ja! Tubime edhe në Gjermani, Zvicër, Austri e Kanada (VIDEO)

20 Shtator, 07:15



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43



Pandeli Majko: Ku gabuam...?



Pandeli Majko

19 Shtator, 19:22



Adri Nurellari: Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi, çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën



Adri Nurellari

19 Shtator, 18:58

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.